

## **SFIDA PËR**

VENDOSJE TË LABORATORËVE  
PËR HULUMTIM, KRIJIM DHE  
INOVACION „MAKERSPACE“





# QËLLIMI I SFIDËS

Sfida për vendosje të laboratorëve për hulumtim, krijim dhe inovacion - MAKERSPACE synon t'u sigurojë të rinjve në komunitet kushte pune, hapësinore, materiale dhe teknike për përvetësimin dhe shkëmbimin e njohurive dhe hulumtimeve, në të cilat do të përdoren mjete nga fusha shkencore, teknologjike dhe industrive kreative. Në të njëjtën kohë, këta laboratorë do të përfaqësojnë një vend për bashkëpunim ndërmjet sektorit privat, institucioneve të arsimit të lartë dhe shkencor, institucioneve arsimore, ndërmarrjeve dhe shoqatave qytetare (sistem heliks i katërfishtë).



# ÇFARË PROJEKTESH DO TË FINANCOJMË

Garuesit duhet të ofrojnë një projekt-propozim për vendosje të një laboratorit për hulumtim, krijim dhe inovacion - "MAKERSPACE" të lokalizuar në kuadër të arsimit të lartë apo institucioneve hulumtuese-shkencore ku të rinjve të moshës 15 deri në 29 vjeç do t'u mundësohet rrjetëzimi, shkëmbimi i përvojave dhe aplikimi i njohurive dhe aftësive, si dhe mbështetje profesionale për hulumtim dhe zhvillim, projektim, testim, zhvillim të linjave pilot, sigurim të cilësisë, marketing dhe shitje, të lidhura drejtpërdrejt me programin e propozuar.

Garuesit pritët të ofrojnë një propozim gjithëpërfshirës që do të përfshijë sa më shumë mundësi, zgjidhje dhe fleksibilitet për grupe të ndryshme të synuara në faza të ndryshme të ciklit të hulumtimit dhe inovacionit, në përputhje me programin dhe specifikat e laboratorit..





# FONDI I SHPËRBLIMEVE

PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE NË  
KUADËR TË KËSAJ THIRRJE ËSHTË  
PARAPARË NJË SHUMË TOTALE PREJ

**20.000.000**

*denarë*

Përmes kësaj thirrjeje, Fondi siguron financim deri në 90% (nëntëdhjetë për qind) të buxhetit të përgjithshëm të projektit, në shumën maksimale prej 5.000.000 (pesë milionë) denarë.

Pjesa e mbetur prej 10% (dhjetë për qind) e buxhetit total për projektin duhet të sigurohet nga aplikuesi. Bashkëfinancimi i ofruar mund të jetë edhe në formën e pjesëmarrjes in-kind.

Përparësi do të kenë ato projekte të propozuara që do të ofrojnë bashkëfinancim monetar nga fondet e veta dhe nga palët e treta (shoqëri tregtare, donatorë, shoqata biznesi, etj.).





# KUSH MUND TË APLIKOJË

Projekti i propozuar mund të dorëzohet nga një garues individual, nga një garues individual në partneritet me persona të tjerë juridikë ose nga një konsorcium i drejtuar nga garuesi udhëheqës.

Kushtet që duhet të plotësojë çdo garues janë:

► Të jetë person juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht:

- (a) universitetet publike në njësitë e tyre të fokusuara në shkencë (institutet e shkencës) dhe në njësitë e fokusuara në arsimin e bazuar në shkencë (fakultete);
- (b) institucionet e pavarura publike të arsimit të lartë;
- (c) institucionet private-publike jofitimprurëse të arsimit të lartë;

(ç) institucionet publike shkencore dhe institucionet e përziera shkencore të themeluara në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë ose Ligjin për Veprimtarinë Kërkimore Shkencore;

(d) shoqëritë tregtare që janë në pronësi dominuese të institucioneve publike të arsimit të lartë (50,1% ose më shumë) që plotësojnë kushtet sipas Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore dhe Dekretit për kushtet dhe procedurën e dhënies së ndihmës me rëndësi të vogël (de minimis);

(dh) persona juridikë të regjistruar në përputhje me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet që janë aktive në fushën e rinisë, arsimit, shkencës, teknologjisë dhe/ose veprimtarisë inovative.



Ambientet e laboratorit për hulumtim, krijim dhe inovacion duhet të jenë në pronësi të:

- ▶ (a) universiteteve publike në njësitë e tyre të fokusuara në shkencë (institutet e shkencës) dhe në njësitë e fokusuara në arsimin e bazuar në shkencë (fakultete);
- ▶ (b) institucioneve të pavarura publike të arsimit të lartë;
- ▶ (c) institucioneve private-publike jofitimprurëse të arsimit të lartë,
- ▶ (ç) institucioneve publike shkencore dhe institucioneve të përziera shkencore të themeluara në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë ose Ligjin për Veprimtarinë Kërkimore Shkencore
- ▶ (d) shoqërive tregtare që janë në pronësi dominuese të institucioneve publike të arsimit të lartë (50,1% ose më shumë).

Në rast se propozim projekti dorëzohet nga një garues i cili nuk zotëron ambientet e laboratorit të prodhimit, përpara lidhjes së marrëveshjes me Fondin, garuesi duhet të ketë një marrëveshje të nënshkruar ose të ketë siguruar letër shprehje interesi për të përdorur ambientet e laboratorit të prodhimit për qëllimet e projektit të shpërblyer për një kohëzgjatje minimale prej 24 (njëzet e katër) muajsh.





# AKTIVITETE TË PRANUESHME PËR FINANCIM

- ▶ Vendorsja (përshtatja dhe arredimi hapësinor) e laboratorit të prodhimit me pajisje për hulumtim dhe zhvillim;
- ▶ Zbatim të programeve për mentorim dhe ofrimin e mbështetjes profesionale për hulumtim dhe zhvillim, dizajnim, testim, zhvillim të linjave pilot, sigurim të cilësisë, marketing dhe shitje, për të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç që lidhen drejtpërdrejt me programin e propozuar.



## LISTA E SUGJERUAR E PAJISJEVE (JO TË DETYRUESHME):

- ▶ Printer 3D
- ▶ Skaner 3D
- ▶ Makinë prerëse lazer në 2D dhe 3D;
- ▶ Makinë CNC me saktësi të lartë për përpunimin e qarqeve elektrike, kallëpeve etj.
- ▶ Makina ruter për përpunimin e drurit
- ▶ Mjete bazë për prerjen, shpimin dhe formësimin e drurit dhe metalit
- ▶ Pajisjet mekanike për kontroll elektronik
- ▶ Pajisje saldimi
- ▶ Instrumente matës
- ▶ Komponentë të ndryshëm elektronikë
- ▶ Makinë për sekuencimin e ADN-së (PCR)
- ▶ Makina qepëse





Laboratori për hulumtim, krijim dhe inovacion duhet të jetë i pajisur me pajisje që korrespondojnë me programin e propozuar dhe që mund të përshtatet me industri specifike (p.sh. tekniko-teknologjike, ushqimore, etj.).

Pas përfundimit të projektit, pajisjet e furnizuara duhet të mbeten në pronësi të përhershme të institucionit të arsimit të lartë/shkencor hulumtues jofitimprurës publik ose privat-publik, ambientet e të cilit përdoren për laboratorin e hulumtimit, krijimit dhe inovacionit.



# SHPENZIMET E PRANUESHME PËR FINANCIM:

- ▶ Furnizimi i pajisjeve për hulumtim dhe zhvillim, duke përfshirë softuerin, si dhe përshtatjen e hapësirës për instalimin e pajisjeve të furnizuara;
- ▶ Furnizimi i materialeve harxhuese për hulumtim dhe zhvillim (komponentë elektronikë, kancelari, literaturë, etj.);
- ▶ Pagat bruto - shumat e pagave bruto për punonjësit e angazhuar në projekt duhet të korrespondojnë me praktikën e vendosura të përfituesit të shpërblimit përpara fillimit të projektit;
- ▶ Angazhimi i konsulentëve për shërbime mentorimi, marketing dhe mbështetje profesionale - deri në 30% të buxhetit total të projektit;
- ▶ Mbështetja e biznesit (shpenzimet e menaxhimit të projektit, shërbimet e kontabilitetit, shërbimet juridike, etj.) – deri në 15% të buxhetit total të projektit;
- ▶ Shpenzimet administrative (komisionet bankare, shpenzimet për shpalljen e thirrjeve publike etj.) - deri në 5% të buxhetit total të projektit.





# PROCESI I VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

## FAZAT E VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES:

- ▶ Kontrolli administrativ i dokumenteve të dorëzuara (nëse dokumentacioni është i plotë dhe në përputhje me kushtet e përshtatshmërisë të specifikuara në thirrjen publike);
- ▶ Vlerësimi i parë i projekt propozimeve (para-përzgjedhja);
- ▶ Selektimi i projekt propozimeve më të mira - pas prezantimit të projekt propozimeve të parapërzgjedhura para Komisionit të vlerësimit dhe përzgjedhjes.

## KOMISIONI I VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

- ▶ Përfaqësues nga Fondi i Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik;
- ▶ Përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- ▶ Përfaqësues nga komuniteti akademik;
- ▶ Përfaqësues nga organizatat partnere;
- ▶ Përfaqësues nga sektori i biznesit (ekspert në fushën e zhvillimit të biznesit).



# KRITERET E VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

Cilësia e projekt propozimit ▶ **20 PIKË**

Cilësia e programit të propozuar ▶ **20 PIKË**

Cilësia e ekipit të projektit ▶ **20 PIKË**

Ndikimi (përsosmëria shkencore-teknologjike, nxitja e aktivitetit inovativ në sektorin privat, punësueshmëria, gjithëpërfshirja, zhvillimi rajonal dhe ekonomik, ndikimi në mjedisin jetësor etj.) ▶ **20 PIKË**

Financim shtesë i siguruar ▶ **10 PIKË**

Rrjetëzimi, promovimi dhe qëndrueshmëria ▶ **10 PIKË**





# MËNYRA E APLIKIMIT

- ▶ Aplikacion projekti të plotësuar, nënshkruar dhe të printuar në formën e përcaktuar nga Fondi, të skanuar në format PDF;
- ▶ Buxhet të projektit - të plotësuar, nënshkruar dhe të printuar në formën e përcaktuar nga Fondi, të skanuar në format PDF;
- ▶ Marrëveshje, letra bashkëpunimi dhe letra që shprehin interesin për ofrimin e mbështetjes financiare/in kind/teknike nga shoqëri tregtare, donatorë, shoqata biznesi, shoqata dhe fondacione të tjera, institucione arsimore etj.;
- ▶ Në rast se ambientet e laboratorit të hulumtimit nuk janë në pronësi të garuesit, garuesi detyrimisht duhet të paraqesë Letër shprehje interesi për dhënien e ambienteve për nevojat e projektit nga një institucion i arsimit të lartë/hulumtues shkencor.



## AFATI I DORËZIMIT TË PROPOZIM- PROJEKTEVE ËSHTË DERI MË 31.10.2022 , DERI NË ORA 14:00.

Formularët për Aplikacionin e Projektit dhe Buxhetit të Projektit janë në dispozicion dhe mund të shkarkohen nga faqja e internetit të Fondit nëpërmjet butonit **“SHKARKO DOKUMENTACIONIN”**.

Dorëzimi i Aplikacionit të Projektit bëhet duke plotësuar të dhënat bazë dhe duke bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm nëpërmjet butonit **“APLIKO”**.

Për të gjitha informatat shtesë mund:

- ▶ të na shkruani në adresën e emailit:  
fondzamladi@fitr.mk

Fondi do të organizojë info-sesione në të cilat do të shpjegojë më në detaje kushtet në thirrjen publike dhe dokumentet e aplikimit.

